



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 65, Datë 08.04.2020

MBI

KËRKESËN E SHOQËRISË “ALBPETROL” SH.A. PËR SHTYRJE TË AFATIT TË PËRFUNDIMIT TË PROCEDURËS SË SHYRTIMIT TË KËRKESËS PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË GAZIT NATYROR TË SHOQËRISË “ALBPETROL” SH.A.

Në mbështetje të nenit 22, pika 2, gërma “c”, të ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar, nenit 53, pika 1 dhe 3, nenit 91 dhe 92, pika 1 dhe 2, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Vendimit të Bordit të ERE nr. 51, datë 26.03.2020 “Mbi disa ndryshime të përkohëshme në procedurat e licencimit në ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror në kuadër të masave pas shfaqjes së virusit covid- 19 dhe shpalljes së gjëndjes së fatkeqësisë natyrore në vendin tonë”, dhe nenit 24, pika 1, të “Rregullores të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 08.04.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë “ALBPETROL” sh.a. për shtyrje të afatit të vendimarrjes së Bordit të ERE”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr.13, datë 23.01.2020, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “ALBPETROL” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të gazit natyror.
- Në këtë vendimarrje është konstatuar dokumentacion i munguar apo që ka nevojë të plotësohet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi.
- Në vijim të kësaj vendimarrjeje, ERE me shkresën nr. 62/2 Prot, datë 24.01.2020, ka kryer njoftimin në median e shkruar.
- Me shkresën nr. 291 prot., datë 28.01.2020, ka përcjellë pranë shoqërisë “ALBPETROL”sh.a., njoftimin për vendimin e fillimit të procedurës dhe për zhvillimin e një seance dëgjimore për të sqaruar në lidhje me dokumentacionin e munguar, atë të plotësuar pjesërisht në aplikimim apo nevojën për informacion shtesë.
- Në seancën e caktuar në datën 07.02.2020, nuk u paraqitën përfaqësuesit e “ALBPETROL” sh.a.,
- ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 291/1 Prot, datë 12.02.2020, duke i rikujtuar kërkesën për plotësim dokumentacioni apo dhënien e informacionit shtesë në lidhje me aplikimin e “ALBPETROL” sh.a.

- Me shkresën protokolluar në ERE nr. 291/2 Prot, datë 02.03.2020, shoqëria “ALBPETROL” sh.a. ka paraqitur kërkesën për shtyrje të afatit të depozitimit të dokumentacionit të munguar në aplikimin për licencim në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror (shitje me pakicë), për shkak se shoqëria është në proces riskstrukturimi.
- Me vendimin nr. 51 datë 26.03.2020, bordi i ERE ka vendosur mes të tjerave: Pezullimin e zbatimit të nenit 9, pika 2, gërma “d” të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 215 datë 20.12.2019 si dhe nenit 9 pika 1 gërma d, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e Gazit Natyror” miratuar nga bordi i ERE-s me Vendimin nr. 97, datë 04.07.2017
- Aktualisht në vend është shpallur gjendja e epidemisë për shkak të Covid 19, Këshilli i Ministrave ka miratuar disa akte normative mbi masat për parandalimin e Virusit Covid 19 duke përcaktuar ndër të tjera edhe kufizim në qarkullimin e njerëzve por edhe kufizim të disa aktiviteteve që nuk do të lejohen gjatë gjendjes së virusit Covid 19.
- Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.243, datë 24.03.2020 është vendosur për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.
- Në rrethanat e masave të jashtëzakonshme të marra nga Qeveria Shqipëtare, si dhe rrethanave të deklaruara nga aplikuesi, plotësimi i dokumentacionit të munguar rezulton i vështirë.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë me 90 (nëntëdhjetë) ditë kalendarike afatin e përfundimit të procedurës së shqyrtimit të kërkesës për licencim në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror të shoqërisë “ALBPETROL” sh.a. duke filluar nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
2. Përrjashtim nga afatet e parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi, bën plotësimi i dokumentacionit të parashikuar në vendimin nr. 51 datë 26.03.2020 të bordit të ERE, nëse përfundimi i gjëndjes së epidemisë Covid 19 zgjatet përtej afatit prej 90 ditësh kalendarike.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI